



Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-34041 /25

Klinë, dt: 09.10 /25

PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun, mbajtur më 16.09.2025, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, ku të pranishëm ishin drejtorë të drejtorive, zyrtarë tjerë komunalë dhe qytetarë të komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

DRAFT-BUXHETI I KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2026

Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhur në këtë takim të organizuar nga Kuvendi i Komunës, në lidhje me draft-buxhetin e komunës për vitin 2026. Fillimisht, ju përshëndes të gjithë ju që jeni prezentë: kryetarë të fshatrave, pjesëmarrës tjerë, drejtorë të drejtorive, për prezencën tuaj. Unë ju falënderoj që i keni lënë angazhimet tuaja për të marrë pjesë bashkë me ne në propozime, ndryshime, plotësime dhe gjithçka tjetër që e shihni të nevojshme në këtë draft, i cili në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat Publike Lokale dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore, duke përfshirë edhe rregulloret e Komunës së Klinës, organizojmë këtë debat para seancës që e kemi më 19 shtator për shqyrtim dhe miratim të këtij dokumenti të rëndësishëm, në bazë të të cilit Komuna e Klinës planifikon për vitin 2026 të gjitha investimet, orientimet dhe planifikimet tjera që mendohet se do t'i shërbejnë qytetarëve tanë. Kam kënaqësinë që para jush ta lus drejtorin e Financave të bëjë një prezantim, pastaj do të hapim debat bashkërisht. Drejtor, e keni fjalën.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për ju të pranishëm,

anëtarë të bashkësive lokale, kolegë drejtorë. Realisht, kemi qenë shumë në analiza dhe jemi të vetëdijshëm që bashkërisht, që nga fillimi i muajit qershor deri sot, jemi duke u bazuar në Ligjin për Financat Publike dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Bashkë me ju, fillimisht me kryetarët e bashkësive lokale, e më pas me të gjithë qytetarët në terren, në takimet që kemi pasur, kemi shpjeguar draft-buxhetin për vitin 2026-2028.

Pas të gjitha atyre analizave, vlerësimeve dhe kompozimeve që kemi marrë nga terreni, kemi ardhur në përfundim që sot t'ju prezantojmë draft-buxhetin për vitin 2026, i cili pikërisht bazohet në kërkesat, sugjerimet dhe nevojat që kanë dalë nga terreni, qytetarët dhe kryetarët e bashkësive lokale. Po ashtu, pas kësaj është bërë një analizë nga grupi punues në kuadër të komunës, bashkë me drejtorët dhe kryetarin, ku secili nga këndi i vet dhe nga përgjegjësia që ka në kuadër të drejtorive, ka planifikuar dhe përgatitur këtë draft-buxhet.

Besoj se draft-buxheti që po prezantohet është gjithëpërfshirës dhe përfshin tërë territorin e komunës sonë, pa dallime, duke marrë parasysh komitetet dhe kërkesat e tjera. Mendoj se pas analizës që do të bëhet edhe nga ju dhe nga Asambleja Komunale në seancën e 19 shtatorit, ky draft-buxhet do të marrë miratimin dhe do të bëhet buxheti i vitit 2026.

Për dijeninë tuaj, falë transparencës që kemi dëshmuar në terren, debateve që kemi zhvilluar bashkë dhe prezantimeve të vazhdueshme të draft-buxhetit dhe shpenzimeve komunale për këtë vit, jemi vlerësuar si komuna më e mirë për transparencë buxhetore, me 100 pikë – kulmin e vlerësimit për draft-buxhetin dhe shpenzimet që komuna po realizon.

Tani do t'ju prezantoj edhe shifrat kryesore të draft-buxhetit për vitin 2026. Brenda materialit që keni marrë janë edhe projektet për vitin 2026-2028. Jam i vetëdijshëm që, për shkak të kufizimeve buxhetore, nuk mund të përfshihen të gjitha nevojat dhe projektet brenda një viti, por kemi bërë një vlerësim se ku janë më të domosdoshme investimet, dhe ato janë vendosur në planin e parë për vitin 2026, ndërsa pjesa tjetër do të vazhdojë në vitet 2027 dhe 2028.

Projekti i buxhetit për vitin 2026 është 16,338,898,00 euro. Ky draft-buxhet përbëhet nga granti qeveritar, të hyrat vetanake dhe donacionet e mundshme që mund të vijnë gradualisht. Nga këto, të hyrat vetanake janë 1,551,784.00 euro, ndërsa granti qeveritar është 14,787,000.00 euro.

Këto mjete janë të ndara në programe të caktuara dhe në 10 drejtoritë e komunës, përfshirë edhe zyrën e kryetarit. Ato janë kategorizuar në paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe shpenzime kapitale.

Paga dhe mëditje për vitin 2026 është 9,567,100.00 euro; Mallra dhe shërbime 1,600,000.00 euro; Shërbime komunale 370,000.00 euro; Subvencione 800,000.00 euro; Shpenzime kapitale 4,170,098.00 euro.

Këto janë shifrat planifikuese për realizimin e projektbuxhetit të vitit 2026, bazuar në projektet që kemi draftuar dhe në shpenzimet e ndara sipas kategorive. Besoj se edhe ju do të keni mundësi të jepni mendime apo propozime të tjera. Bazuar në debatet që kemi pasur deri tani, shumica e projekteve janë dakorduar në takimet paraprake, mirëpo nëse ka diçka tjetër për të thënë apo kërkuar, jemi këtu për t'i shtuar si propozim para Asamblesë Komunale më 19 shtator. Faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor. Atëherë po hap debat. Nëse dikush dëshiron të marrë fjalën, por para se të filloni, ju lutem prezantohuni shkurtimisht, për mua jeni të njohur të gjithë, por ndoshta nuk jeni të njohur mes veti. Ju lutem, urdhëroni.

Musa Rrustemi (Gjurgjevik i Vogël): Përhëndetje, unë jam Musa Rrustemi nga Gjurgjeviki i Vogël, komuna e Klinës. Kam pasur një kërkesë që e bëj prej gashtë vitesh, katër herë me

shkrim dhe rreth pesë herë në zyrën e kryetarit të komunës. Nuk kam pasur mundësi të lexoj të gjitha pikat për buxhetin, por dua të përmend që në Gjurgjevik të Vogël, dmth në livadhe poshtë, nuk është bërë asnjë vlerësim nga kryetari i komunës.

Më vjen keq që nuk është këtu Zenun Elezaj, sepse kam pasur dëshirë, edhe pse kam shkuar tre-katër herë në zyrën e tij. Na ka lënë pas dore, dmth si fshat, në Gjurgjevik të Vogël, sepse ne jemi tri lagje që nuk kemi pasur asnjë investim. Nuk është bërë asnjë investim prej tij, as ndriçim, as emërtim rrugësh, as shtyllat nuk janë ndërruar, dhe asfaltin që e kam kërkuar prej 18 metrash, nuk është bërë.

Firma që ka punuar më ka premtuar se kur të mbetet asfalt diku tjetër, do të vijnë ta shtrojnë edhe te ne. Por deri më sot, askush nuk ka ardhur. Para një muaji, ne si banorë kemi marrë vetë iniciativën dhe kemi shtruar 8 metra asfalt me mjete vetanake, dhe e kemi njoftuar komunën, por edhe kjo ka mbetur vetëm në nivel premtimi.

Kërkesat e mia i kam dërguar edhe sot me shkrim, për herë të pestë. Nëse realizohen, mirë, nëse jo, një fjalë e urtë popullore thotë: “Në mulli flitet katër a pesë herë”. Por në Gjurgjevik të Vogël, në lagjet Krasniqi, Thaçi, Gashi, Rustemi, nuk është bërë asgjë.

Vetëm një dritë është vendosur në fund të lagjes, por ajo është e prishur dhe nuk funksionon. Për këto vite, nuk është bërë asgjë.

Fadil Gashi, kryesues: Ky organizim bëhet nga Kuvendi, jo nga kryetari. Kam nevojë të ta sqaroj ty dhe të gjithë të tjerëve se mungesa e kryetarit nuk ka të bëjë me mungesë dëshire, por sepse është një aktivitet i organizuar nga Kuvendi Komunal. Jemi dy institucione të ndara. Kryetari ka pasur gatishmëri për të ardhur, por nuk e ka pasur të domosdoshme, sepse kjo është organizuar nga ne. Së dyti, kompetencat e kryetarit mos i përzieni. Emërtimi i rrugëve nuk është përgjegjësi e tij.

Do të na ndihmonit shumë nëse e vlerësoni këtë dokument që e keni përpara, ta plotësoni dhe ta ndryshoni. Kjo është ideja: çka mund të shtojmë, çka mund të heqim, çka mund të bëjmë. Faleminderit shumë!

Musa Rustemi (Gjurgjevik i Vogël): Unë për këtë e thashë. Nëse është e mundur të shtohen rreth 10,000 euro për lagjen poshtë te ne, atëherë do të përfundonin këto projekte. Propozimi im është ky: nëse mund të ndahet një buxhet për këto katër lagje, që të realizohen investimet. Ndriçimi mund të bëhet, shtyllat mund të ndërrohen; ai është “zoti i shtëpisë”, është “zoti i komunës”. Asfaltimin mund ta realizojë. Për emërtimin më ka thënë se bëhet në vitin 2026.

Fadil Gashi, kryesues: Emërtimi është kompetencë e Kuvendit dhe, për të qenë i sinqertë, as komisioni nuk ka arritur ta kryejë detyrën e vet, kështu që të gjithë kemi mbetur në vend. Faleminderit shumë. Dikush tjetër? Po, urdhëron drejtori i Urbanizmit, z. Enver Berisha, pastaj z. Binak Gashi.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Përshëndetje, kryesues, të nderuar kryetarë të bashkësive lokale. U përmend se nuk është investuar në Gjurgjevik, por unë kam qenë deri te rruga juaj. Kam shkuar për të parë një trase për transit, e cila kalon edhe përmes Qerkinajt dhe kah zona juaj, por nuk pashë rrugë lokale. Ndoshta kanë ndodhur ndryshime si ndërtimi i shtëpive të reja apo zhvendosje e vendbanimeve. Për asfaltimin nevojitet kohë. Nuk kam dijeni që ka rrugë të pashtuara, përderisa e dimë se pothuajse shumicën po i mbulojmë shtëpi për shtëpi.

Sa i përket emërtimit të rrugëve, kjo është një çështje tjetër. Është krijuar një komision nga Kuvendi dhe funksionon në përputhje me vendimet e tij. Po ashtu, ndriçimi publik është projekt. Gjurgjeviku i Vogël është pjesë e këtij projekti, dhe unë mendoj se po punohet; madje, edhe sot është punuar, dhe do të përfundohet.

Të thuhet se “nuk është bërë asgjë nga kryetari i komunës për 10 metra rrugë” – nuk mendoj se është një vlerësim i drejtë, sepse është punuar. Megjithatë, duhet të jemi modestë dhe të mos fokusohemi vetëm në zonën tonë. E di që shpërndarja e investimeve është bërë në mënyrë të barabartë. E përmenda këtë për të qenë më i qartë. Faleminderit.

Musa Rrustemi: Unë nuk e di në cilën rrugë paske ardhur ti, por unë thashë se na kanë ndarë lagjen prej lagjes. Ti paske ardhur poshtë, kurse ne e kemi lagjen tjetër që shkon kah Thaçët. Aty janë rreth 18 metra asfalt. Dy herë e kemi hequr zhavorrin vetë, por kanë dalë përsëri bagremët. Herën e tretë e kemi shtruar vetë atë rrugë, dhe tani na kanë mbetur edhe vetëm 8 metra. Pra, 10 metra i kemi shtruar vetë, e 8 metra kanë mbetur. Unë nuk thashë se nuk na kanë shtruar fare, por se na kanë ndarë lagjen prej lagjes.

Fadil Gashi, kryesues: Keni mundësi deri të premtën të konsultoheni dhe t’i dërgoni vërejtjet apo propozimet tuaja edhe përmes emailit, në mënyrë elektronike, në adresat që i keni. Po, urdhëron, z. Binak Gashi.

Binak Gashi: Përshëndetje. Kam dy çështje për të ngritur. E para, çështja e kanalizimit në fshatin Dollc. Tashmë është duke u ndërtuar rruga e re, domethënë autostrada, dhe duhet të gjendet një zgjidhje për kanalizimin. Kam biseduar edhe me kryetarin, është fjala për shtëpinë e pleqve, ku, kur të lëshohet kanalizimi i përbashkët, duhet të kyçet edhe ajo.

Por një çështje tjetër, më serioze dhe urgjente, ka të bëjë me reshjet atmosferike që vijnë nga Përçeva dhe derdhen në Drinin e Bardhë, përkatësisht te dalja te Krasniqt në Gremnik. Aty aktualisht është e bllokuar. Nuk e di nëse do të hapet apo jo, por më herët ka ekzistuar një kanal që derdhej direkt në Drinin e Bardhë. Tani ajo rrugë është asfaltuar. Unë e shoh si çështje serioze sepse, edhe pse nuk kemi pasur reshje shumë të mëdha, duhet të parashikohet një zgjidhje, pasi ekziston rreziku real i vërshimeve.

E kam parë edhe në Dush, ku në hapjen e lumit që është bërë, 90% e rrezikut të përmbytjeve është shmangur. Duhet të merren masa parandaluese sa më parë.

Kjo çështje duhet të futet në plan për ujërat atmosferike që derdhen në Drinin e Bardhë; duhet të mundësohet një kanal. E dimë që çdo dimër kemi probleme me atë pjesë, sepse nuk ka dalje për ujërat.

Po ashtu, për sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, kemi pasur bisedë edhe me kryetarin, edhe me kryesuesin. Një pjesë është e bllokuar, është vendosur një kanalizim i ri, bashkëfshatarët na kanë lejuar, por ende nuk janë kyçur, as ata, dhe as kjo pjesa poshtë Gremnikut. Nuk kemi kanalizim. Kjo është urgjente, sepse në të ardhmen duhet bërë trajtimi i ujërave të zeza. Kaq kisha.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Binak. Po, urdhëro, drejtor.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit, Binak. Tani po ju informoj të gjithëve lidhur me Dollcin dhe Dresnikun. Ne e dimë që është një fshat i shpërndarë, në fakt, është një lagje e Klinës, por është aq shumë i shpërndarë sa që kërkon një gjatësi të konsiderueshme për t’u

mbuluar i gjithë territori. Vit pas viti, me të dhëna të sakta, kemi planifikuar rreth 46 mijë metra. Dhe kjo duhet të rregullohet vit pas viti. Pra, lagjet Dollc-Dresnik, këto dy fshatra, kanë një shpërndarje të tillë që kërkon shumë kohë për t'u kompletuar tërësisht me kanalizim. Ne e kemi përfshirë në projekt, dhe do ta vazhdojmë deri në përfundim. Kemi një problem të vazhdueshëm me pronat – në shumicën e rasteve, pronarët na thonë që rrugët i kanë të parcelizuara dhe, për shkak të kësaj, nuk po mundemi të kalojmë. Të marrim drejt për drejt në shpronësim është një temë shumë e gjatë dhe një proces që zgjat me vite.

Prandaj, kemi vepruar përmes marrëveshjeve me kryetarët e fshatrave, duke u dakorduar në përqindje. Diku po arrihet mirëkuptimi, diku jo, por puna ka vazhduar çdo vit. Për sa i përket depërtimit të rrugës, kemi biseduar edhe me operatorin ekonomik që është duke punuar, që të na lejojë depërtimin, por ajo nuk varet nga ne. Sepse është një aset që menaxhohet nga Ministria përkatëse. Ne planifikojmë të dalim me dy gypa përtej trasesë së rrugës që është kah fshati Kjevë-Zahaq, mirëpo, përsëri, ajo nuk është në kompetencën tonë të drejtpërdrejtë. Mund të ushtrojmë presion, por deri tani nuk na kanë marrë shumë parasysh për këtë pjesë.

Sa i përket asaj lagjes që u përmend, unë vetë jam marrë drejtpërdrejt me atë çështje dhe kam kërkuar nga ky Kuvend një buxhet rreth 10.000 euro, me kusht që të bëjmë edhe një projekt shtesë brenda këtij viti. Jemi duke pritur vendimin nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për ligjshmërinë e rialokimit. Zyrtarët e kanë pasur telashe, por gjithsesi, është një rrjet kanalizimi i vjetër dhe është punuar vazhdimisht në atë pjesë. Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor. Po, urdhëro i nderuar.

Rasim Marmullaku: Përshëndetje! Pak e shikova këtë material dhe më ra në sy një çështje – rrethojat e varrezave. Nuk janë përfshirë të gjitha fshatrat. Janë përfshirë vetëm disa fshatra dhe të tjerat figurojnë nën një aneks “të tjera”. Tani, nuk e di nëse përfshihen edhe fshatrat e tjera, apo janë vetëm ato që janë të përmendura me emër. Më konkretisht, mungojnë fshatrat si Dushi, Jellovci, Resniku, e kështu me radhë.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: I nderuar, nuk është përgjegjësi e drejtorisë së Urbanizmit, por meqë nuk është drejtori përkatës këtu, po e jap një sqarim. Aty ku shkruan “të tjera”, do të thotë se përfshihen të gjitha fshatrat që nuk janë përmendur me emër. Prandaj kemi shkruar: “Ky, ky, ky, dhe të tjerat”, që do të thotë se përfshihen të gjitha. Besoj se do të trajtohen të gjitha, pasi është një proces që po vazhdon.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit. Dikush tjetër? Po, urdhëroni.

Skënder Veseli: Ju përshëndes të gjithëve. Vetëm doja të bëja një pyetje: a ka mundësi që për fshatrat Dresnik dhe Dollc, ku janë bërë shumë ndërtime, komuna të ndërhyjë për ta rregulluar situatën urbanistike, ose të ndalojë ndërtimet e reja?

Sepse, duke parë për shembull në Google, shihet se para 40 vjetësh lagjet janë urbanizuar në një mënyrë, ndërsa tash po ndërtohet pa rregull. Nëse kjo vazhdon edhe për 25 vite të tjera, çfarë do të ndodhë me ato rrugica që po ndërtohen pa plan? A nuk është më mirë të ndërhyjmë tani?

Ose ndalojmë ndërtimet e reja, ose fillojmë një proces urbanizimi. Sepse nuk duket mirë situata, duhet të gjejmë një zgjidhje. Nuk është punuar deri më tani në këtë drejtim, dhe ndërtimet po vazhdojnë pa ndërprerje. Më e keqja, askush nuk ka ndërprerë ndërtimet pa leje që dy vjet me radhë. Prandaj mendoj se duhet të bëjmë një zgjidhje: ose urbanizim, ose ndërprerje të

ndërtimeve. Faleminderit shumë.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit. Urdhëro, drejtor.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit, Skënder. Sa di unë, jeni të njoftuar që dokumenti planifikues i komunës është miratuar në Kuvend dhe ka marrë ligjshmërinë, pra tash është i vlefshëm si plan zhvillimor komunal.

Në pjesën ku janë bërë ndërtime pa leje, madje edhe shumica me leje, ne kemi tentuar që ato zona ku ka shumë shtëpi t'i përcaktojmë si zona ndërtimore. Sepse është e palogjikshme të quhet tokë bujqësore një zonë ku ka ndërtime të shumta.

Në planin zhvillimor kemi përfshirë rrethin e dytë të mbrojtjes, ku është zona arkeologjike përgjatë rrethit të dytë. Gati 70% e asaj zone është tokë ndërtimore. Pjesa sipër mbi "Summer love" andej ka qenë e ndarë si tokë bujqësore për shkak të shtëpive më të vogla, por ministria nuk e ka pranuar këtë pasi zona është parcelizuar komplet me parcela të vogla 4-6 ari. Kjo na sjell probleme për ta konsideruar si tokë bujqësore.

Sa i përket ndërtimeve të egra, përgjegjësi ka inspektorati për të dhënë informacionin, por ne kemi tentuar vazhdimisht të mos lejojmë ndërtimin e shtëpive pa leje. Janë duke u zhvilluar procedurat për ata që kanë ndërtuar pa leje.

Një çështje e çuditshme është që shtëpitë e ndërtuara para vitit 2018 nuk janë parashikuar në tokë bujqësore, që është padrejtësi sepse komshiu mund ta ndërtojë shtëpinë, ndërsa tjetri jo. Nëse ka paqartësi, unë jam këtu për t'i sqaruar. Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit drejtor, dikush tjetër?

Musa Rrustemi: Kam një pyetje: për transitin që kalon nga Gjurgjeviki i Vogël, çfarë ka ndodhur? A është ndalur puna?

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Realisht, puna nuk është ndalur, por ka ngadalësime. Po presim shpronësimin. Është bërë elaborati, i kemi kryer gjitha procedurat tona, por shpronësimin e bën ministria përkatëse. Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush tjetër? Nëse jo, ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe ju kujtoj që deri të premtën keni mundësi të dërgoni komentet dhe propozimet tuaja edhe në mënyrë elektronike. Faleminderit edhe njëherë!

Procesmbajtësja:
Monika Palushi

MPalushi



KRYESUESI:
Fadil Gashi

Fadil Gashi